

URDHËR
Nr. 84, datë 29.1.2025

PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR. 1131, DATË 27.12.2024, “PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE NË KAFSHËT E GJALLA TË LLOJIT DERRA TË BUTË, NË MJEDISËT E HAPURA DHE NË TREGJET E KAFSHËVE TË GJALLA”

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 1131, datë 27.12.2024, “Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në kafshët e gjalla të llojit derra të butë, në mjediset e hapura dhe në tregjet e kafshëve të gjalla”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj